




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA DOGANORE BLLATË

Nr. 360/c Prot.

Bllatë, më 07.10.24 2024



Lënda: Kërkesë për njoftim publik

**DREJTORISË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE**

**DREJTORISË SË PLANIFIKIMIT DHE ANALIZËS SË TË ARDHUARVE**  
**Sektorit të Monitorimit të Borxhit**

**DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE**

**TIRANË**

Në zbatim të marrjes së masave për rikuperimin e borxhit doganor, mbështetur në Ligjin Nr.102/2014, datë 31.07.2014 « Kodi Doganor i Republiks së Shqipërisë », i ndryshuar, Udhëzimin nr.15, datë 03.12.2018 të DPD-së « Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës », kreu IV, pika 3/b, si dhe Ligjin nr.44/2015, datë 30.04.2015 « Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë » neni 162, pika 2, në pamundësi për të kryer njoftimin me mënyra të tjera, kërkojmë kryerjen e njoftimit publik të vendimit **nr.360 prot., datë 18.03.2024 « Për rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor »**, të Degës Doganore Bllatë (Peshkopi), të marrë ndaj shtetasit **Klodian Balliu me ID: I80628127U**, duke e publikuar në rubrikën « Njoftime » të faqes ëeb të Institucionit.

Bashkëlidhur keni kopje të vendimit nr.360 prot., datë 18.03.2024 « Për rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor », të Degës Doganore Bllatë (Peshkopi) dhe shkresën Njoftim Vendimi “ Për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor ”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**KRYETARI**

**Bajram KALIA**

Adresa: Bllatë, Njësia Administrative Maqellarë, Bashkia Dibër



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PERGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA DOGANRE BLLATË

Nr. 360/1 Prot.

Bllatë, më 18/03/2024

NJOFTIM VENDIMI

**“PËR RIKUPERIMIN ME FORCË TË BORXHIT DOGANOR”**

Drejtuar: Subjektit **Klodian Balliu** me ID: **I31011087R**

**Adresa:** *Bashkia Bulqizë, Njësia Administrative Gjoricë, fshati Gjoricë e Poshtme, rruga "Jella Ballie", nr. i ndërtesës 25"*

Në zbatim të Ligjit nr.102, date 31.07.2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, VKM Nr.651, datë 10.11.2017 "Per dispozitat zbatuese te Kodit Doganor", i ndryshuar.

**Ju njoftojmë se:**

Dega Doganore Bllatë me vendimin nr.50, datë 29.12.2023, ka vendosur për shtetasin **Klodian Balliu**, të shpallet debitor për:

- Shumën **59,319 lekë** penalitet

Ky vendim ju është njoftuar përmes shpalljes publike në bashkinë Bulqizë dhe në faqen ëeb të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Në kushtet kur nga ana juaj nuk është kryer likuidimi në mënyrë vullnetare të detyrimeve të vendosura në vendimin e mësipërm, në zbatim të neneve 280, 283 të Kodit Doganor, Dega Doganore Bllatë, ka nxjerrë Vendimin nr. 360 prot., datë 18.03.2024 "Për rikuperimin me forcë të borxhit doganor", një kopje të të cilit e keni bashkëlidhur.

**KRYETAR**

**Bajram KALIA**

Një kopje e këtij njoftimi është dorëzuar më datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / \_\_\_\_ pranë qendrës së subjektit të mësipërm.

Firma e marresit (ose ne rastin e personit juridik e perfaqesuesit)	Marresi nuk gjendet Shkresa e njoftimit u dorezua:	Marresi/ personat e tjere te percaktuar nga ligji refuzojne te nenshkruajne.
	Firma e _____ (Shenoni lidhjen e ketij personi me marresin)	Nepunesi qe ben njoftimin / deshmitari Nepunesi qe ben njoftimin/ deshmitari

*Adresa: Bllatë, Njësia Administrative Maqellarë, Bashkia Dibër*





ADMINISTRATA DOGANORE  
Dega e Doganës Bllatë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
Dega Doganore Bllatë

Nr. 360 Data 18.03.24 Dalja  
PROTOKOLLI

VENDIM

Datë 18.03.2024

“Për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor”

Subjektit: Klodian Balliu me ID: I80628127U

Dega Doganore Bllatë me vendimin nr. 50, datë 29.12.2023, ka vendosur kontabilizimin dhe arkëtimin e borxhit doganor në shumën gjithsej 59,319 lekë në formën e penaltetit, që shtetasi Klodian Balliu ka ndaj Degës Doganore Bllatë. Njoftimi i vendimit të mësipërm është nisur me postë, por, posta e ka kthyer mbrapsht me shënimin “larguar”, megjithëse e kemi nisur në adresën e deklaruar në gjendjen civile të subjektit. Ndodhur në këto kushte me shkresën nr.1421/3 prot., datë 29.01.2024 i kemi kërkuar Njesisë Administrative Gjoricë të bashkisë Bulqizë, njoftimin publik të vendimit të mësipërm duke e afishuar në këndin e njësisë/bashkisë për njoftime publike. Me shkresën nr.58 prot., datë 12.02.2024 Njësia Administrative Gjoricë ka konfirmuar se ka kryer shpalljen publike të njoftimit të vendimit më datë 12.02.2024. Njëkohësisht ky vendim është shpallur dhe në faqen ëeb të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave në rubrikën “njoftime”.

Meqë subjekti i mësipërm nuk ka kryer likuidimin e detyrimeve të përcaktur në vendimin nr. 50, datë 12.02.2024, të Degës Doganore Bllatë, në mënyrë vullnetare, brenda afatit 10 ditor, nga marrja e njoftimit, me qëllim rikuperimin me forcë të borxhit doganor prej 59,319 (pesëdhjetë e nëntë mijë e treqind e nëntëmbëdhjetë) lekë , që shtetasi Klodian Balliu me adresë: *Bashkia Bulqizë, Njësia Administrative Gjoricë, fshati Gjoricë e Poshtme, rruga "Jella Ballie", nr. i ndërtesës 25* ka ndaj Degës Doganore Bllatë, në zbatim të nenit 106 dhe 280 të Kodit Doganor, nenit 511 e vijues të K.Pr.Civile dhe Udhëzimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nr.15, datë 03.12.2018 “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”,

Vendosa që :

1. Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, valutë të huaj të depozituara në bankë që u përkasin debitorit, personave të tretë apo garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit të mësipërm.
2. Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme dhe të patundshme që i përkasin debitorit, personave të tretë apo garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
3. Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve të mësipërme konkretisht shuma prej 59,319 (pesëdhjetë e nëntë mijë e treqind e nëntëmbëdhjetë) lekë deri në likuidimin e plotë të borxhit doganor, në bazë të nenit 106 dhe 280 të Kodit Doganor.

KRYETAR

Bajram KALIA

Adresa: Bllatë, Njësia Administrative Maqellarë, Bashkia Dibër